

## Kategoria Superiore/ Lushnja - Partizani 2-0

nga AlbaniaSoccer

E shtunë, 19 Tetor 2013 17:11

---



Lushnja ka marre tre pike te rendesishme ndaj Partizanit. Lagunaret, nen nje atmosfere elektrizuese kane shenuar dy here ne porten e te kuqve. Skuadra e Likes ka qene ne nje dite te keqe dhe pergjate gjithë ndeshjes nuk ka patur force per te reaguuar. Nje gol i te talentuarit Trashi dhe nje tjetër nga Korreshi i kane dhene tre piket e cmuara skuadres qe drejtohet nga Bano. Tifozet lushnjar, rreth 8 mije ne numer kane festuar gjate ne stadium por dhe jashte tij. Partizani eshte dorezuar pas disa ndeshjesh mjaft te mira ka marre dy gola dhe nje humbje qe i largon me kreun.